



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 2623/prot
12

Gramsh, më 03.07/2026

V E N D I M

Nr 47 datë, 30/06/2026

P Ë R

KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH DEGA E TATIMEVE" PASURIA NR. 9/97-N2 DHE 9/97-N3, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, PËR QËLLIME STREHIMI DHE PRIVATIZIMI.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 30 / 06 /2026, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike.

Bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 885 datë 03.11.2010 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 431, datë 11.12.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", dhe për një ndryshim në Vendimin nr.818. datë 06.12.2006, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve".

Mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 179, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", të ndryshuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

1. Kthimin në fond banese të objektit "Ish Dega e Tatimeve", në pronësi të bashkisë Gramsh, ndarjen dhe certifikimin e çdo njësie banimi sipas listës së miratuar të banoreve që banojnë në to duke specifikuar dhe sipërfaqet respektive të tyre.

2. Nisjen e procedurave të privatizimit të familjareve që banojnë si më poshtë:

**LISTA EMERORE E OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA
OBJEKTI NR.1**

**PASURIA NR 9/97 N3 ME SIPËRFAQE TOTALE S-292 M² DHE SIP. NDËRTESE S-200 M².
EMËRTIMI: ISH DEGA E TATIMEVE, KATI PËRDHE.**

ME POSEDUES:

- 1.Venera Bici, me S-94.3 m².
- 2.Shpëtim Brahimi, me S-50 m².
- 3.Fatos Hysa, me S-55.7 m².

OBJEKTI NR.2

**PASURIA NR 9/97 N2 ME SIPËRFAQE TOTALE DHE SIP. NDËRTESE S-130 M².
EMËRTIMI: ISH DEGA E TATIMEVE, KATI I PARË.**

ME POSEDUES:

- 1.Abedin Bici, me S-105.4 m².
- 2.Shpëtim Brahimi, me S-24.6 m².

3. Vlersimi i pronës të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar.

4. Në përfundim të procedurës të lidhen kontratat e shitjes para noterit midis qytetarëve të mësipërm në cilësinë e blerësit dhe Bashkisë Gramsh në cilësinë e shitësit i përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Privatizimit të banesave pronë e bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

